



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**“K.F. LUSHNJA 1930” sh.a.**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lushnje, më \_\_\_\_ .01.2022

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i sigurisë fizike në stadium” Marrëveshje Kuadër -  
me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodet CPV:  
66162000- 3, 79713000-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL /VLERA E PRITSHME E KONTRATAVE: 1 521 129** (një milion e pesëqinda e njezet e një mijë e njeqind e njezet e nente) **leke pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Klubi Futbollit Lushnja 1930 sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

*b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.1.1** Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin

**2.2.1** Kopje të deklaratës së xhiros mesatare vjetore të tre viteve të fundit (2018,2019,2020) lëshuar nga Administrata Tatimore, e cila duhet të jete 40 % e vleres se parashikuar te kontrates; Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky vërtetim duhet të paraqitet nga secili prej pjestarëve të bashkimit

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore*

*minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % te vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

**2.2.2 .** Kopje të certifikuara të bilancit të konfirmuar me vulë pranë Autoriteteve Përkatese (Administrata Tatimore) të tre viteve (2018,2019,2020) të fundit qe te tregojne raportet,ndermjet aktivitet dhe pasivitet.Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nese ne dy bilance te njepasneshme nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të plotësohet nga çdo anëtar i bashkimit sipas legjislacionit tatimor në fuqi;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht ne ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 pranë të gjitha njësive vendore ku operatori ekonomik ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKB-së. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky vërtetim duhet të paraqitet nga secili prej pjestarëve të bashkimit);

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1.** Punë të ngjashme (e cila provon përvojën e mëparshme) për shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- *Për kontrata të realizuara me Institucione shtetërore:* vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- *Për kontrata të realizuara me subjekte private:* vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 55, pika 4(b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

### 2.3.2 Licencat që duhet të disponojnë operatorët ekonomike :

- i. Operatori ofertues duhet të paraqesë Licensë QKL për ushtrim aktiviteti në fushën e “Sigurimi Privat të sigurisë fizike“, leshuar konform Ligjit nr. 75 datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike“, në kategorinë 1.3 A.
- ii. Certifikate e titullarit të subjektit të vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, leshuar në bazë të ligjit 75/2014 dhe udhëzimit të Minitrisë së Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, në kategorinë 1.3 A.
- iii. Çertifikatë e Drejtuesit Teknik shoqëruar me cv e tij për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, leshuar në bazë të ligjit 75/2014 dhe udhëzimit të Minitrisë së Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, në kategorinë 1.3 A.
- iv. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën sa numri i punonjësve të kërkuar, në bazë të ligjit 75/2014 dhe udhëzimit të Minitrisë së Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, në kategorinë 1.3 A për të paktën 30 punonjës shërbimi, të leshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier.
- v. Akti i Miratimit të Qendres së Kontrollit miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun Fier si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik ku të pasqyrohet grupi i gatshëm i subjektit, për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar, të leshuar jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave .

vi. Autorizim Individual ne emer te shoqerise per perdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm te leshuar nga AKEP ne zbatim te ligjit nr.9918,date 19.05.2008 “ Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise “,me zone mbulimi Fier,Lushnje

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

### **2.3.3 Dëshmi per fuqine mesatare punetore te operatorit ekonomik :**

Nje punesim mesatar i te pakten 30 (tridhjetë) personave duke perfshire stafin e perhershëm,per muajt tetor,nentor,dhjetor viti 2021,te vertetuar me :

1.Vërtetim te leshuar nga Sigurimet Shoqerore ose Administrata Tatimore ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj.

2.Listepagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore,Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi ( Formulari numer E-SIG 025/a.1) per muajt Tetor,Nentor dhe Dhjetor viti 2021

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike dhe termat e references jane hartuar nga specialistet e fushes.*

*Kriteret e vecanta te kualifikimit jane hartuar nga specialistet e fushes pjese e njesise se prokurimit.*

## **Njesia e Prokurimit**